

DISKURS URREJTËS DHE DISKRIMINUES ONLINE NË SHQIPËRI



Raport Vjetor, 2024

Prodhuar dhe publikuar nga:



Qëllimi i projektit Living Safely in a Digital World (LIFE), i propozuar nga ky konsorcium, është rritja e reziliencës së brezit të ri përballë rreziqeve të digjitalizimit dhe ndikimit të tij në jetën e përditshme, përmes fuqizimit të organizatave rinore për t'u përfshirë në dialogun politik dhe për të përdorur të nxënit joformal në punën e tyre me të rinjtë.

“Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.”

Table of Contents AMAD Albania Annual Report 2024

1. EXECUTIVE SUMMARY	3
2. SURVEY AND FOCUS GROUP RESULTS.....	4
<i>a) Quantitative data on demography.....</i>	<i>4</i>
<i>b) Qualitative data on demography.....</i>	<i>5</i>
<i>c) Online media and social network usage.....</i>	<i>5</i>
<i>d) Experience with Hateful Discriminatory Discourse (HDD).....</i>	<i>5</i>
<i>e) Personal experience with hate speech.....</i>	<i>6</i>
<i>f) Perception of presence of HDD online.....</i>	<i>6</i>
<i>g) Sources of Hate Discriminatory Discourse (HDD).....</i>	<i>6</i>
<i>h) Emotional and psychological reactions to HDD.....</i>	<i>7</i>
3. DESK RESEARCH AND MONITORING RESULTS.....	8
3.1 <i>Dominant HDD categories.....</i>	<i>8</i>
3.2 <i>Platforms and amplification dynamics.....</i>	<i>9</i>
3.3 <i>Targets and harms.....</i>	<i>9</i>
3.4 <i>Institutional responses and case outcomes.....</i>	<i>9</i>
3.5 <i>Patterns and risks.....</i>	<i>9</i>
4. CONCLUSION AND RECOMMENDATIONS.....	10
4.1 CONCLUSIONS.....	10
4.2 RECOMMENDATIONS	11
5. ANNEX (Detailed table with 15 cases identified by monitoring).....	16

1. Përmbledhje e përgjithshme

Në vitin 2024, Autoriteti Shqiptar për Median Digjitale (AMAD) zhvilloi një studim në shkallë kombëtare për të shqyrtuar gjendjen e sigurisë digjitale dhe përhapjen në rritje të diskursit urrejtës dhe diskriminues (HDD) në Shqipëri. Duke u mbështetur në një kombinim metodash sasore dhe cilësore, përfshirë anketa, grupe fokusi, kërkim në burime dytësore (desk research) dhe monitorim të vazhdueshëm online, studimi ofron një pasqyrë të thelluar mbi qëndrimet e publikut, sjelljet online dhe përpjekjet institucionale për adresimin e dëmeve digjitale.

Gjetjet paraqesin një tablo të detajuar të peizazhit digjital në Shqipëri, ku pjesëmarrja online është e lartë, por ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dëmshme dhe diskriminuese po bëhet gjithnjë e më i shpeshtë dhe shqetësues. Studimi përfshiu një spektër të gjerë demografik, me përfaqësim të veçantë të rinjve të moshës 15–29 vjeç, të cilët përbënin 38.1% të të gjithë të anketuarve. Ky grup, shumë aktiv në hapësirat digjitale, pasqyron njëkohësisht mundësitë dhe cenueshmëritë e komunitetit online në Shqipëri. Pothuajse 44.2% e pjesëmarrësve raportuan se kalojnë disa orë në ditë në rrjete sociale dhe platforma online, duke theksuar rolin qendror që këto hapësira luajnë në jetën e përditshme.

Studimi evidentoi gjithashtu një prirje shqetësuese: rritjen e ndjeshme të urrejtjes dhe diskursit diskriminues online. Më shumë se një e treta e të anketuarve (35.7%) raportuan se përballen me HDD çdo ditë, ndërsa pothuajse dy të tretat (64%) e hasin atë në mënyrë të rregullt. Akoma më alarmante është se tre nga katër të anketuar (75.5%) deklaruan se kanë përjetuar personalisht gjuhë urrejtjeje online. Një shumicë dërrmuese (82.3%) beson se ky fenomen është në rritje, duke reflektuar një ndërgjegjësim dhe ankth në rritje të publikut lidhur me normalizimin e urrejtjes në hapësirat digjitale.

Në identifikimin e burimeve kryesore të këtij përmbajtjeje të dëmshme, të anketuarit evidentuan disa sektorë me ndikim të lartë. Programet reality u përmendën nga 98.6% e pjesëmarrësve si nxitës kryesorë të narrativave diskriminuese, të ndjekura nga afër nga influencerët në rrjetet sociale (96.2%) dhe aktorët politikë (84.5%). Këto gjetje nxjerrin në pah rolin e medias dhe figurave publike, të cilat përmes argëtimit dhe komunikimit politik formësojnë diskursin publik dhe shpesh kontribuojnë në përhapjen e ndarjes dhe armiqësisë online.

Ndikimi njerëzor i këtij mjedisi është i konsiderueshëm. Shumë të anketuar raportuan reagime të forta emocionale ndaj gjuhës së urrejtjes online: 36.1% deklaruan se ndihen të mërzhitur ose të trishtuar, 24.5% u ndjenë të frikësuar ose të kërcënuar, ndërsa 16.5% shprehën dëshirën për të reaguar ose për t'u përfshirë në nisma ndërgjegjëse. Këto reagime tregojnë qartë se urrejtja dhe diskriminimi online nuk janë çështje abstrakte, por kanë pasoja reale emocionale dhe psikologjike, duke cenuar mirëqenien individuale dhe kohezionin shoqëror.

Kërkimi në burime dytësore dhe monitorimi mediatik i kryer nga AMAD i përforcuan më tej këto gjetje. Përmbajtjet me bazë gjinore dhe mizogjiniste rezultuan si forma më e shpeshtë e HDD-së, të pranishme shpesh në deklarata publike, programe argëtuese dhe komente online. Diskursi urrejtës etnik dhe nationalist ishte gjithashtu i theksuar, veçanërisht në kontekste sportive dhe politike, ndërsa praktikatat sensacionaliste mediatike dhe niveli i ulët i edukimit digjital kontribuan në amplifikimin e narrativave të dëmshme. Megjithatë ndërhyrjet e AMAD-it – që varionin nga referimi i rasteve dhe kërkesat për heqje përmbajtjeje deri te thirrjet për

ndjesë publike – sollën disa rezultate pozitive, efektet mbetën të pabarabarta, duke nxjerrë në pah nevojën për mekanizma institucionalë më të fortë dhe më të koordinuar.

Bazuar në këto gjetje, studimi paraqet disa rekomandime kyçe. Së pari, edukimi për aftësitë digjitale dhe sigurinë online duhet të forcohet në shkallë kombëtare, duke pajisur si brezin e ri ashtu edhe brezat më të rritur me mjetet e nevojshme për të përballuar në mënyrë të përgjegjshme rreziqet në hapësirat digjitale. Së dyti, kornizat rregullatore duhet të përforcohen për të garantuar llogaridhënie të mediave, influencerëve dhe platformave digjitale në lidhje me përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Së treti, vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet mbështetjes së viktimave, përmes kanaleve të aksesueshme të raportimit, shërbimeve këshillimore dhe fushatave ndërgjegjëse që synojnë zbutjen e ndikimit të abuzimit online në shëndetin mendor.

Njëkohësisht, aktorët politikë dhe mediatikë duhet të marrin përgjegjësi më të madhe për gjuhën dhe sjelljen e tyre, duke nxitur një kulturë komunikimi etik dhe respekti në diskursin publik. Në fund, edhe vetë qytetarët duhet të inkurajohen të luajnë një rol aktiv në kundërshtimin e urrejtjes, përmes angazhimit komunitar, aktivizmit online dhe avokimit për hapësira digjitale më të sigurta.

Studimi Vjetor i AMAD-it për vitin 2024 evidenton nevojën urgjente për veprime gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara kundër rritjes së urrejtjes dhe diskriminimit në ekosistemin digjital të Shqipërisë. Duke ndërthurur edukimin, rregullimin, mbështetjen për viktimat dhe angazhimin qytetar, Shqipëria mund të ecë drejt një mjedisi online më të respektueshëm, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë.

2. Rezultatet e sondazhit dhe fokus-grupit


Anketa mblodhi të dhëna si sasiore ashtu edhe cilësore, duke ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të çështjes në fjalë.

a) Të dhëna sasiore mbi demografinë

Anketa synoi të anketuar nga grupe të ndryshme moshe, duke siguruar një kampion të larmishëm dhe përfaqësues. Shpërndarja e të anketuarve sipas grupmoshave është si vijon:

- 20–24 vjeç: 21.3%
- 15–19 vjeç: 26.1%
- 25–29 vjeç: 12%
- 30–35 vjeç: 11.6%
- 36–39 vjeç: Të dhënat për këtë grup ishin disi më të ulëta dhe janë përfshirë në kategori më të gjera.
- 40–50 vjeç: Përqindja e të anketuarve në këtë grup përbënte gjithashtu një pjesë të rëndësishme të të dhënave të përgjithshme të anketës.
- Mbi 50 vjeç: Përfaqësonin një pjesë më të vogël të popullatës së anketuar.

Grup-mosha e personave të përfshirë në studim



Këto përqindje pasqyrojnë larminë moshore të pjesëmarrësve, me përfaqësim të theksuar të grupeve më të reja të moshës, veçanërisht atyre 15–29 vjeç (38.1%), duke treguar një angazhim

të fortë të të rinjve. Ky profil demografik paraqitet vizualisht në grafikun shoqërues, i cili ofron një pamje më të qartë të shpërndarjes.


b) Të dhëna cilësore mbi demografinë

Aspekti cilësor i anketës u bazua në pyetje të hapura, duke u dhënë mundësi të anketuarve të ndanin mendime të detajuara, përvoja dhe shqetësime lidhur me sigurinë digjitale. Këto të dhëna nxorën në pah disa tema të rëndësishme, përfshirë:

- Të anketuarit nga grupe të ndryshme moshe shfaqën nivele të ndryshme ndërgjegjësimi mbi rreziqet/kërcënimet digjitale, ku grupmoshat më të reja treguan shqetësim më të lartë për privatësinë online dhe sigurinë kibernetike.
- Sjelljet online dhe praktikatat e sigurisë: shumë pjesëmarrës shprehën shqetësime mbi gjurmën e tyre digjitale, veçanërisht në kontekstin e rrjeteve sociale. Pjesëmarrësit më të rinj, sidomos ata të grupmoshës 15–29 vjeç, ishin më të zëshëm lidhur me sfidat që hasin në ruajtjen e privatësisë.
- Aksesin në edukimin digjital: disa pjesëmarrës theksuan nevojën për më shumë programe të edukimit digjital, me fokus në praktikatat e sigurta online dhe masat e sigurisë kibernetike. Shumica e të anketuarve mbi moshën 40 vjeç nënvizuan rëndësinë e këtij edukimi për brezat më të rritur, të cilët mund të mos jenë aq të aftë në përdorimin e teknologjisë digjitale.

c) Përdorimi i mediave online dhe rrjeteve sociale


Anketa tregoi se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 44.2%, kalojnë disa orë çdo ditë në platforma mediatike dhe rrjete sociale. Kjo thekson rolin gjithëpërfshirës të platformave digjitale në jetën e përditshme, veçanërisht te grupmoshat më të reja. Përdorimi i rrjeteve sociale ishte një aspekt qendror i anketës, me pjesëmarrës nga të gjitha grupmoshat që raportuan përfshirjen e tyre në platforma të ndryshme online.



d) Përvoja me Diskursin Urrejtës dhe Diskriminues (HDD)

Anketa vlerësoi gjithashtu shpeshësinë e përbaljes me HDD, një çështje gjithnjë e më shqetësuese në hapësirat digjitale. Gjetjet treguan se:

- 35.7% e të anketuarve raportuan se përballeshin me HDD çdo ditë, çka sugjeron një prani të konsiderueshme të diskursit të dëmshëm online dhe është veçanërisht shqetësuese për nga rregullsia dhe ndikimi në përvojën digjitale të përdoruesve.
- 28.1% e të anketuarve deklaruan se hasin HDD 3–4 herë në javë, duke treguar se ky fenomen është i shpeshtë dhe i vazhdueshëm, edhe nëse nuk ndodh çdo ditë.




Këto gjetje nënvizojnë përhapjen alarmante të përmbajtjeve urrejtëse dhe diskriminuese në mjediset digjitale, me pothuajse 64% të të anketuarve që e përjetojnë atë rregullisht. Të

dhënat theksojnë nevojën urgjente për ndërhyrje që adresojnë ngacmimin dhe diskriminimin online, veçanërisht në hapësirat mediatike dhe rrjetet sociale që dominojnë ndërveprimet digjitale të përditshme.

e) Përvoja personale me gjuhën e urrejtjes

Një përqindje shumë e lartë, 75.5% e të anketuarve, raportuan se kanë përjetuar drejtpërdrejt gjuhë urrejtjeje online. Kjo tregon një ekspozim të gjerë dhe të konsiderueshëm ndaj përmbajtjeve të dëmshme digjitale, duke theksuar seriozitetin e problemit në grupe të ndryshme




demografike. Përvoja me gjuhën e urrejtjes nuk ishte e kufizuar në grupe të caktuara moshe, por ishte e përhapur gjerësisht, duke reflektuar një shqetësim serioz për sigurinë digjitale dhe mirëqenien e përdoruesve.

f) Perceptimi mbi praninë e HDD-së online

Një shumicë dërrmuese, 82.3% e të anketuarve, deklaruan se besojnë se HDD-ja është në rritje me kalimin e kohës. Ky perceptim pasqyron shqetësimin në rritje për normalizimin e gjuhës së urrejtjes dhe sjelljeve diskriminuese në hapësirat digjitale. Fakti që një përqindje kaq e lartë e pjesëmarrësve vëren rritjen e HDD-së tregon një prirje më të gjerë që kërkon përgjigje sistematike nga politikëbërësit, kompanitë teknologjike dhe platformat digjitale për të frenuar përhapjen e saj. Këto gjetje theksojnë jo vetëm ndikimin personal të gjuhës së urrejtjes tek individët, por edhe ndërgjegjësimin në rritje për përshkallëzimin e saj në peizazhin digjital. Të dhënat nxjerrin në pah nevojën urgjente për rregullime më të forta, nisma të edukimit digjital dhe ndërhyrje që synojnë reduktimin e gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e një mjedisi online më të sigurt.

Situata aktuale e gjuhës së urrejtjes online



g) Burimet e Diskursit Urrejtës dhe Diskriminues (HDD)

Gjetjet tregojnë se disa grupe dhe platforma perceptohen si kontribuues kryesorë në përhapjen e HDD-së:

▪ Politika / Politikanët


Një përqindje e konsiderueshme, 84.5%, e të anketuarve identifikuan politikën dhe politikanët si burim kryesor të HDD-së. Kjo sugjeron se diskursi politik, si në hapësira publike ashtu edhe

në rrjete sociale, shpesh karakterizohet nga retorikë përçarëse, e dëmshme dhe diskriminuese, duke përkeqësuar tensionet online dhe duke kontribuar në rritjen e përgjithshme të gjuhës së urrejtjes.

▪ Programet “Reality”

Një përqindje edhe më e lartë, 98.6%, identifikoi programet reality si një tjetër burim madhor të HDD-së. Natyra sensacionaliste dhe shpesh konfrontuese e këtyre formateve televizive, veçanërisht kur trajtojnë tema të ndjeshme ose individë nga grupe të marginalizuara, duket se nxit diskutime negative online dhe përforcon stereotipe të dëmshme.

Përzetimet nga përballja me gjuhë urrejtje



▪ Influencerët në rrjetet sociale

Një përqindje e lartë, 96.2%, theksoi influencerët e rrjeteve sociale, veçanërisht në platforma si TikTok, si nxitës kryesorë të HDD-së. Shtrirja e gjerë e influencerëve, sidomos atyre që prodhojnë përmbajtje kontroverze ose provokuese, kontribuon në përhapjen e narrativave të dëmshme dhe sjelljeve diskriminuese, veçanërisht te audiencat më të reja.

Këto rezultate tregojnë se, ndonëse politikanët, programet reality dhe influencerët identifikohen si burime kryesore të HDD-së, secili luan një rol të veçantë në formësimin e diskursit publik dhe ndikimin e sjelljeve online. Njohja e gjerë e këtyre aktorëve si kontribuues kyç në gjuhën e urrejtjes thekson nevojën për ndërhyrje të synuara që adresojnë këto burime me ndikim të lartë, me qëllim frenimin e trendit në rritje të diskriminimit online dhe retorikës së dëmshme.

h) Reagimet emocionale dhe psikologjike ndaj HDD-së

Një përqindje e konsiderueshme, 36.1% e të anketuarve, raportuan se ndihen të mërzhitur dhe të trishtuar kur përballen me HDD online. Ky reagim emocional nënvizon shqetësimin personal të shkaktuar nga ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dëmshme dhe diskriminuese, duke evidentuar barrën emocionale që gjuhë e urrejtjes online mund të ketë mbi individët.

24.5% e të anketuarve deklaruan se ndihen të frikësuar, të shqetësuar ose të kërcënuar kur përballen me HDD. Kjo sugjeron se për shumë persona, përvoja me gjuhën e urrejtjes shkon përtej parhatisë emocionale, duke nxitur ndjenja pasigurie dhe frike për sigurinë personale, veçanërisht në një mjedis online ku anonimiteti mund të përforcojë ndjesinë e kërcënimit.

16.5% e të anketuarve raportuan se ndjejnë dëshirën për të reaguar ose për t'u përfshirë në veprime ndërgjegjëse në përgjigje të HDD-së. Kjo tregon se një pjesë e pjesëmarrësve e sheh këtë fenomen si një thirrje për veprim aktiv, qoftë përmes avokimit online apo pjesëmarrjes në nisma që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes.

16.9% e të anketuarve deklaruan se nuk shqetësohen nga HDD-ja, pasi nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i sulmeve. Edhe pse ky grup mund të mos ndihet i prekur personalisht, ai përfaqëson një segment të individëve që mund të jenë më pak të ndjeshëm ndaj përmbajtjes ose që e perceptojnë atë si një pjesë “normale” të ndërveprimit online.

Këto gjetje nxjerrin në pah efektet e ndryshme emocionale dhe psikologjike që HDD-ja online ka mbi individët, nga trishtimi dhe frika, deri te dëshira për veprim proaktiv. Të dhënat theksojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi online mbështetës dhe ndërmarrjes së veprimeve për të reduktuar ndikimet negative në shëndetin mendor të lidhura me gjuhën e urrejtjes digjital.

3. Rezultatet e kërkimit në burime dytësore dhe monitorimit

Kjo analizë shqyrton rastet e mbledhura nga AMAD gjatë vitit 2024 dhe identifikon modele të përsëritura, grupe të prekura, shpërndarjen sipas platformave, reagimet institucionale dhe boshllëqet ekzistuese. Evidenca tregon se: (1) diskursi urrejtës dhe diskriminues me bazë gjinore dhe mizogjiniste përbën kategorinë më të shpeshtë në të dhënat e mbledhura; (2) diskursi urrejtës etnik/nacionalist shfaqet dukshëm në kontekste sportive dhe në raste që përfshijnë figura publike; (3) sensacionalizmi mediatik dhe niveli i ulët i edukimit mediatik kontribuojnë në amplifikimin e narrativave të dëmshme; dhe (4) ndërhyrjet e AMAD-it përfshijnë rregullisht referimin e rasteve pranë institucioneve kombëtare mbikëqyrëse (Institucioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut / Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Autoriteti i Mediave Audiovizive), kërkesa për heqje përmbytjeje dhe thirrje për ndjesë publike – me rezultate të përziera. Rastet përfaqësuese dhe rekomandimet paraqiten më poshtë. **(Në ANEKS gjendet tabela e detajuar e çdo rasti, me përshkrim, analizë dhe lidhje përkatëse.).**

3.1 Kategoritë dominuese të HDD-së

- Diskurs urrejtës me bazë gjinore / Mizogjini

Kategoria më e madhe dhe më e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme. Shembujt përfshijnë deklarata mizogjiniste nga figura publike në televizione kombëtare (Bujar Kapexhiu), ngacmim seksist në programe reality (Big Brother VIP), sulme të drejtuara ndaj një gjyqtareje femër në futboll (Emanuela Rusta), si dhe fajësim të dhunshëm të viktimës pas abuzimit përmes imazheve intime (rasti Altin Çoku / Sibela Abedini). AMAD ka regjistruar ndërhyrje ose referime institucionale për shumë prej këtyre rasteve.

- Diskurs urrejtës etnik / nacionalist

Disa incidente me profil të lartë lidhen me tensione etnike, si deklaratat e aktorit kosovar Osman Azemi që nxitën debate ndërkufitare, kërcënimet ndaj një gazetari për veshjen e një fanele me flamurin serb (Ervin Baku), si dhe thirrjet nacionaliste nga një lojtar i kombëtares shqiptare gjatë UEFA-s (Mirlind Daku). Këto raste shpesh amplifikohen përmes rrjeteve të tifozëve dhe mediave sociale.

- Gjuhë diskriminuese mbi orientimin seksual / LGBTI+

Evidentuar përmes deklaratave të aktorëve politikë (si deklarata protestuese e Silvana Çakës), të cilat përdorin terma fyese dhe nxisin diskurs armiqësor ndaj komunitetit LGBTI+.

- Dështime në edukimin mediatik dhe sensacionalizëm

Media online dhe llogari në rrjete sociale përdorin në mënyrë të përsëritur tituj klikbait, forma të turpërimit moral ose tituj keqorientues (shembuj: JOQ, titujt e Top Channel në raport me Kostana Moravën, titulli i NOA që thekson gjininë e drejtueses së mjetit), duke nxitur HDD-në dhe ngacmimin online. AMAD i kategorizon shumë prej këtyre rasteve si probleme të edukimit mediatik dhe etikës profesionale, më tepër sesa incidente të izoluara të gjuhës së urrejtjes.

3.2 Platformat dhe dinamikat e amplifikimit

- Ndërthurja e mediave tradicionale dhe platformave sociale

Shumë incidente e kanë origjinën në televizione ose media tradicionale dhe më pas përhapen në YouTube, Instagram, TikTok dhe seksione komentesh (p.sh. deklaratat e Kapexhiut në Top Channel, podcast-e që bëhen virale). Kjo shpërndarje hibride rrit shtrirjen dhe përshpejton përshkallëzimin e përmbajtjes së dëmshme.

- Amplifikimi i drejtuar nga përdoruesit

Edhe kur përmbajtja origjinale hiqet (p.sh. heqja e një klipi podcast-i), ripostimet dhe fragmentet e saj vazhdojnë të qarkullojnë në rrjetet sociale, duke zgjatur dëmin. AMAD ka vërejtur ripostime të përsëritura edhe pas heqjes së përmbajtjes origjinale.

3.3 Grupet e synuara dhe dëmet e shkaktuara

Grupet e prekura përfshijnë gratë (profesioniste, figura publike dhe individë privatë), pakicat etnike (romë/egjiptiane), aktorë politikë, sportistë dhe persona LGBTI+. Dëmet variojnë nga dëmtimi i reputacionit dhe turpërimi publik, deri te kërcënimet e drejtpërdrejta, publikimi i të dhënave personale (doxxing) dhe, në të paktën një rast, ngjarje të lidhura me vetëvrasjen e një individi. Baza e të dhënave dokumenton si diskurs fyës, ashtu edhe dëme konkrete materiale (kërcënime, shantazh).

3.4 Reagimet institucionale dhe rezultatet e rasteve

AMAD ndërmori veprime përmes referimit të rasteve pranë institucioneve kombëtare (Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi, Autoriteti i Mediave Audiovizive), kontaktimit telefonik të prodhuesve të përmbajtjes për kërkesa heqjeje dhe trajnime, monitorimit të vazhdueshëm dhe thirrjeve për ndjesë publike. Disa raste u konsideruan “të adresuara” ose “të zgjidhura” (p.sh. ndjesa publike e Kapexhiut; heqja e një lidhjeje podcast-i), ndërsa të tjera mbeten të regjistruara, në proces ose nën monitorim. Kjo tregon angazhim aktiv institucional, por gjithashtu nxjerr në pah zbatim të pabarabartë dhe rezultate të ndryshueshme në korrigjimin e rasteve.

3.5 Modele dhe rreziqe

Përsëritja e shkelësve dhe normalizimi i diskursit urrejtës: rikthimi i kornizimeve mizogjiniste dhe sensacionaliste nga të njëjtat media dhe figura publike sugjeron një normalizim të këtyre praktikave brenda kulturës mediatike.

Heqjet nga platformat janë të paqëndrueshme: largimi i përmbajtjes në burim nuk e ndalon ripërhapjen, por nxjerr në pah boshllëqet e moderimit në raste të tilla.

Sporti, argëtimi, politika dhe media informative përbëjnë vektorë të ndërlidhur të HDD-së; për këtë arsye nevojiten ndërhyrje ndërsektoriale dhe jo masa të kufizuara vetëm në një sektor, të cilat kanë efekt të kufizuar.

4. Përfundime dhe Rekomandim

Raporti Vjetor i Monitorimit Online i AMAD-it për vitin 2024 në Shqipëri ofron njohuri të vlefshme mbi gjendjen e sigurisë digjitale, përhapjen e diskursit urrejtës dhe diskriminues (HDD), si dhe ndikimin që ky diskurs ka në shëndetin mendor dhe mirëqenien e individëve. Raporti evidenton prirje kyçe në përdorimin e mediave online, përvojat personale të individëve me gjuhën e urrejtjes dhe barrën emocionale që shoqëron përballjen me përmbajtje diskriminuese. Më poshtë paraqiten gjetjet kryesore të këtij studimi vjetor.

4.1 Përfundime

Studimi Kombëtar i AMAD-it për vitin 2024 mbi Sigurinë Digjitale dhe Diskursin Urrejtës dhe Diskriminues (HDD) ofron një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të sfidave me të cilat përballlet mjedisi online në Shqipëri. Gjetjet tregojnë një shoqëri shumë të angazhuar në hapësirat digjitale, por gjithnjë e më të ekspozuar ndaj sjelljeve të dëmshme dhe diskriminuese online.

Studimi konfirmon se ekspozimi ndaj gjuhës së urrejtjes dhe diskursit diskriminues është i përhapur dhe i vazhdueshëm, duke prekur përdorues nga të gjitha grupet demografike. Më shumë se një e treta e të anketuarve përballen me HDD çdo ditë, ndërsa pothuajse dy të tretat e përjetojnë atë rregullisht. Fakti që tre nga katër individë kanë përjetuar personalisht gjuhë urrejtjeje nënvizon seriozitetin dhe përhapjen e gjerë të këtij fenomeni.

Po aq shqetësues është edhe perceptimi publik se urrejtja dhe diskriminimi online janë në rritje, çka sinjalizon një normalizim në rritje të armiqësisë dhe intolerancës në komunikimin digjital. Ndikimi emocional dhe psikologjik i këtij ekspozimi është i konsiderueshëm: shumë të anketuar raportuan ndjenja trishtimi, ankthi ose frike kur përballen me urrejtje online, ndërsa të tjerë shprehën frustrim dhe dëshirë për ndryshim.

Monitorimi dhe kërkimi në burime dytësore i kryer nga AMAD-i i përforcojnë këto shqetësime. Të dhënat tregojnë se diskursi me bazë gjinore dhe mizogjinist mbetet forma më e shpeshtë e HDD-së, e ndjekur nga diskursi urrejtës etnik dhe nacionalist. Sensacionalizmi mediatik, niveli i pamjaftueshëm i edukimit digjital dhe zbatimi i paqëndrueshëm i rregullave rregullatore kontribuojnë më tej në përforcimin e këtyre prirjeve. Programet reality, diskursi politik dhe përmbajtja e prodhuar nga influencerët u identifikuan si kontribuues kryesorë, duke formësuar narrativa online që shpesh riprodhojnë ndarje dhe diskriminim.

Ndërkohë që ndërhyrjet e AMAD-it (përfshirë referimet pranë institucioneve mbikëqyrëse kombëtare, kërkesat për heqje përmbajtjeje dhe nismat për ndjesë publike) kanë sjellë disa rezultate pozitive, efektet kanë qenë të pabarabarta. Kjo tregon nevojën për koordinim institucional më të fortë, mekanizma më të qartë llogaridhënieje dhe një qasje më sistematike për kundërshtimin e sjelljeve të dëmshme digjitale.

Gjetjet tregojnë se siguria digjitale përbën një sfidë njëkohësisht shoqërore dhe institucionale, e cila kërkon pjesëmarrjen aktive të politikëbërësve, aktorëve mediatikë, institucioneve arsimore dhe shoqërisë civile për të ndërtuar një mjedis online më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës në Shqipëri.

4.2 Rekomandimet

Bazuar në gjetjet e studimit, AMAD propozon këto veprime strategjike për forcimin e sigurisë digjitale, reduktimin e urrejtjes dhe diskriminimit online dhe ndërtimin e reziliencës digjitale afatgjatë:

1. Forcimi i edukimit dhe aftësive digjitale

Zhvillimi i programeve kombëtare të edukimit digjital që promovojnë sjellje të sigurt, respektuese dhe të informuara online. Këto programe duhet të synojnë si të rinjtë ashtu edhe brezat më të rritur, duke u fokusuar në tema si privatësia online, bullizmi kibernetik, identifikimi i gjuhës së urrejtjes dhe etika mediatike. Partneritetet me shkollat, universitetet dhe organizatat komunitare janë thelbësore për qëndrueshmërinë e këtyre nismave.

2. Përforsimi i rregullimit dhe llogaridhënies së platformave

Vendosja e standardeve më të qarta dhe më efektive rregullatore për identifikimin, raportimin dhe adresimin e gjuhës së urrejtjes online. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve, transmetuesve dhe platformave digjitale për të siguruar heqjen e shpejtë të përmbajtjeve të dëmshme dhe mbajtjen përgjegjëse të aktorëve që kontribuojnë në përhapjen e tyre.

3. Mbështetja e viktimave dhe promovimi i mirëqenies mendore

Krijimi i mekanizmave të aksesueshëm për raportimin dhe mbështetjen psikologjike të individëve të prekur nga urrejtja online. Zhvillimi i linjave të ndihmës online, shërbimeve këshillimore dhe fushatave ndërgjegjësuere që informojnë mbi burimet ekzistuese. Forcimi i mbrojtjes ligjore dhe ofrimi i ndihmës së përqendruar të viktimave mund të ndihmojnë në uljen e barrës emocionale të abuzimit online.

4. Nxitja e komunikimit etik politik dhe mediatik

Promovimi i komunikimit të përgjegjshëm ndërmjet politikanëve, gazetarëve dhe influencerëve. Diskursi publik (si online ashtu edhe në mediat tradicionale) duhet të bazohet në respekt, saktësi faktike dhe përgjegjësi shoqërore. Partitë politike dhe organizatat mediatike duhet të miratojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje për të dekurajuar gjuhën diskriminuese ose nxitëse.

5. Nxitja e angazhimit qytetar dhe veprimit kolektiv

Inkurajimi i pjesëmarrjes qytetare në përpjekjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes përmes nismave komunitare, fushatave ndërgjegjësuere dhe aktivizmit online. Studimi tregon se një pjesë e të anketuarve janë të motivuar të veprojnë kundër urrejtjes, ky momentum duhet të mbështetet dhe të përforcohet përmes programeve që promovojnë qytetarinë digjitale dhe solidaritetin.

Studimi Vjetor i AMAD-it për vitin 2024 evidenton nevojën kritike për strategji gjithëpërfshirëse në adresimin e rritjes së gjuhës së urrejtjes dhe diskursit diskriminues online. Duke u fokusuar në edukim, rregullim, mbështetje për viktimat dhe angazhim të përgjegjshëm digjital, është e mundur të ndërtohet një mjedis online më i sigurt dhe më gjithëpërfshirës për të gjithë përdoruesit.

ANEKS

Raste të raportuara të Diskursit Urrejtës dhe Diskriminues Online (HDD) / Shkelje të Edukimit Mediatik						
Raporti Vjetor, 2024						
N r.	Platforma / Media	Lloji i HDD-së	Kush e artikuloi	Përshkrim i përmbledhur	Statusi i rastit	Komente dhe rekomandime për rastin
1	Top Albania Radio / Channel (media kombëtare transmetuese), e publikuar gjithashtu në YouTube dhe Instagram	Mizogjini / Diskriminim gjinor / HDD	Bujar Kapexhiu – Artist / Producent filmi, i mbështetur nga moderatorët e programit radio/TV	Qershor 2024 – Figura e njohur publike shqiptare e 50 viteve të fundit deklaroi se “gratë nuk janë të afta të prodhojnë humor”, duke argumentuar se “humori është privilegj i njerëzve të mençur/inteligjentë”. Këto deklarata u shoqëruan me mbështetje dhe të qeshura nga drejtuesit e programit, duke amplifikuar HDD-në e prodhuar. Lidhje: https://top-channel.tv/2024/06/13/femer-qe-shkruan-humor-nuk-ka-habit-kapexhiu-eshte-privilegj-i-te-mencurve-edhe-barcalelat-i-sajojne-vete-meshkujt/ www.youtube.com/watch?v=18R1z5A_HVk www.gazetatema.net/sociale/video-bujar-kapexhi-skandalizon-me-deklaraten-e-tij-humori-eshte-privile-i444193	I zgjidhur	Rasti u paraqit zyrtarisht nga AMAD pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD – NHRI), duke adresuar HDD-në e artikulluar drejtpërdrejt ose të amplifikuar nga i ftuari dhe moderatorët e programit. AMAD kërkoi ndjesë publike nga z. Kapexhiu dhe përputhje të Top Albania Media me etikën mediatike. KMD e ndoqi rastin ligjërisht. Z. Kapexhiu dhe media paraqitën ndjesë publike në të njëjtin program në dhjetor 2024. Lidhje: https://top-channel.tv/2024/12/11/femrat-nuk-e-kane-kapacitetin-per-te-sajuar-barcaleta-bujar-kapexhiu-sqaron-deklaraten-jane-keqkuptuar1 www.youtube.com/watch?v=AqzeGpDGmw0
2	Klan Kosova	Diskurs urrejtës etnik	Osman Azemi – aktor komik kosovar	Gusht–Shtator 2024 – Deklaratat e aktorit kosovar Osman Azemi në një intervistë në Kosova TV shkaktuan reagime të forta publike dhe mediatike. Azemi deklaroi se “shqiptarët e Shqipërisë kanë inate ndaj atyre të Kosovës”, duke nxitur polemika të gjera në Shqipëri dhe Kosovë. Figura të njohura të muzikës dhe skenës shqiptare e dënuan ashpër deklaratën, përfshirë reperë si Noizy, Stresi dhe Tayna shprehën kundërshtimin e tyre, ndërsa Noizy reagoi duke ironizuar deklaratat e Azemit. Ardit Bido, Drejtor i Arkivave të Shqipërisë, reagoi gjithashtu duke e quajtur Azemin “trupeshk” (term fyes), duke e krahasuar me figura të tjera që ai i konsideroi me vlerë më të ulët.	I adresuar	Rasti u adresua nga AMAD si një nevojë për forcimin e edukimit mbi komunikimin etik të figurave publike dhe u vendos si prioritet për hartimin e një plani ndërgjegjësues gjatë vitit të dytë (2025) të zbatimit të projektit LIFE.

				Ky incident, i cili përfshiu si fyerje verbale ashtu edhe deklarata me ngarkesë nacionaliste, nxiti një debat të gjerë publik mbi tensionet etnike dhe perceptimin e shqiptarëve përtej kufijve. Reagimi i Azemit, i publikuar në rrjetet sociale, riafirmoi qëndrimin e tij, duke ushqyer më tej polemikat. Lidhje: www.youtube.com/watch?v=mUNr-qssV-A		
3	Tik Talk (podcast – kanal YouTube), Media Online dhe Rrjete Sociale	Mizogjini / HDD	Arjan Çani – drejtues programi televiziv, i ftuar në podcast; Marsid Gupi – drejtues i podcast-it	Gusht 2024 – Një video e Arjan Çanit duke folur në një podcast u bë virale, duke tërhequr vëmendje të gjerë publike. Në video, Çani kritikon ashpër gazetarin dhe drejtorin televiziv Artur Zheji, të cilin e quan “obez” dhe “kumarxhi”, si dhe ish-politikanen e kthyer në moderatore televizive, Grida Duma. Çani e sulmon veçanërisht Dumën, duke iu referuar asaj me terma fyes, duke e quajtur “Suma”, një deformim i mbiemrit të saj. Ai e përdor këtë si lojë fjalësh me kuptim vulgar, pasi “Suma” në zhargonin shqiptar nënkupton “vithe”, duke sugjeruar një fyerje të seksualizuar. Çani gjithashtu tall përdorimin e fjalës “momentum”, duke e quajtur Dumën “idiote e niveleve të larta”. Ai kritikon gjithashtu Zhejin si “i shëndoshë” dhe “kumarxhi”, duke e akuzuar se mban anën e Dumës, të cilën Çani e përshkruan si “jo zonjë”. Një nga moderatorët e podcast-it bashkohet me një koment të rëndë, duke thënë: “Ajo e ka atë mbiemër, o vëlla, mendon me bythë.” Lidhje: www.gazetatema.net/lifestyle/arian-cani-shperthen-ndaj-grida-dumes-debile-e-niveleve-te-larta-nje-vj-i454145	I zgjidhur	Rasti u paraqit nga AMAD pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive në Shqipëri. AMAD kontaktoi gjithashtu personalisht prodhuesit e podcast-it përmes telefonit, duke kërkuar heqjen e përmbajtjes dhe duke sugjeruar trajnime mbi edukimin mediatik për drejtuesit e podcast-it. Si rezultat, lidhja u hoq nga YouTube. Lidhje e hequr: www.youtube.com/watch?v=example Megjithatë, përmbajtja vazhdon të qarkullojë në rrjete sociale dhe YouTube përmes ripostimeve nga përdorues të tjerë që e kanë amplifikuar. Lidhje: https://youtube.com/shorts/a6r4aXSwwOI?si=Sds8jXFk-ll17hYV www.instagram.com/p/C-5ehkctRUv/
4	Media kryesore, Media Online dhe Rrjete Sociale	Diskurs urrejtës etnik dhe kërcënime për shkak të përdorimit të simboleve në sfond	Telegrafi / Komentues	Gusht 2024 – Gazetari sportiv Ervin Baku u përball me kërcënime dhe sulme verbale pasi u shfaq në një intervistë televizive i veshur me një bluzë që mbante flamurin serb. Kjo ngjarje shkaktoi reagime të forta publike, duke çuar në fyerje, kërcënime dhe stigmatizim, me shumë komente që vinin në pikëpyetje patriotizmin dhe besnikërinë e tij ndaj Shqipërisë. Incidenti nxiti një debat më të gjerë mbi lirinë e shprehjes në Shqipëri dhe mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënime të tilla, ndërkohë që urrejtja online dhe komentet nxitëse përforcuan më tej situatën, duke reflektuar një mjedis politikisht të polarizuar. Lidhje: https://telegrafi.com/skandaloze-gazetari-	I adresuar	AMAD, përmes gazetarit të projektit LIFE – Change Agent, kontaktoi Unionin e Gazetarëve Shqiptarë (UGSH). UGSH publikoi një deklaratë për shtyp duke dënuar sulmet dhe duke bërë thirrje për veprime të menjëhershme ligjore, si dhe duke theksuar agresionin ndaj lirisë individuale. Lidhje: www.balkanweb.com/kercenimet-ndaj-gazetarit-sportiv-ervin-baku-agresion-ndaj-lirise-individuele-unioni-i-gazetareve-

				rtsh-se-ervin-baku-paraqitet-ne-lidhje-direkte-fanellen-e-serbise/ https://newsbomb.al/aktualitet/u-shfaq-me-fanellen-e-serbise-ne-lidhje-te-drejtperdrejt-kercenohet		shqiptare-vleresojme-plotesisht-faljen-publike-te-kolegut-poli/#gsc.tab=0
5	Media sociale dhe media online	Diskurs urrejtës mbi orientimin seksual / HDD – nxitje urrejtjeje ndaj komunitetit LGBTI+	Silvana Çaka	Tetor 2024 – Gjatë një proteste përpara Bashkisë së Tiranës, Silvana Çaka, Zëvendëssekretare e Partisë së Lirisë në Shqipëri, bëri deklaratën kontroverze: “Shqiptarët nuk janë pederasta”. Kjo deklaratë u regjistrua në video dhe u përhap gjerësisht online, duke tërhequr vëmendje të madhe dhe duke nxitur diskutime në platforma të ndryshme mediatike dhe rrjete sociale. Përdoruesit shprehën një gamë të gjerë reagimesh mbi këtë çështje. Ngjarja nënvizon shqetësimet e vazhdueshme lidhur me përdorimin e gjuhës diskriminuese nga figura publike në Shqipëri dhe ndikimin e saj në qëndrimet shoqërore ndaj komuniteteve të marginalizuara.	I regjistruar	Incidenti u pasqyrua gjerësisht në mediat shqiptare, të cilat theksuan natyrën nxitëse të gjuhës së përdorur dhe pasojat e mundshme për diskursin publik. Termi “pederast” konsiderohet fyes dhe ofendues, dhe përdorimi i tij në këtë kontekst u kritikua për riprodhimin e stereotipeve të dëmshme dhe kontributin në diskurs diskriminues.
6	Platforma online dhe media sociale	Diskurs urrejtës dhe diskriminues ; sensacionalizëm, klikbait, turpërim moral, stereotipizim seksual i grave, standarde të dyfishta në diskursin gjinor, nxitje e talljes publike, diskriminim mbi bazë moshe, stereotipizim kulturor,	JOQ Albania dhe JOQ News	Mars–Tetor 2024 – Platforma mediatike online JOQ, si në faqen e saj ashtu edhe në profilet në rrjete sociale, ka paraqitur në mënyrë të vazhdueshme përmbajtje që nxit Diskurs Urrëjtës dhe Diskriminues. Janë evidentuar praktika sensacionaliste, klikbait, turpërim moral, stereotipizim seksual i grave, standarde të dyfishta në diskursin gjinor, nxitje e talljes publike. Shembuj postimesh: www.instagram.com/p/DDJysn5tt90/ Në një rast, JOQ Albania publikoi emrat dhe fotografitë e një çifti, duke nxitur ekspozim dhe gjykim publik. Postimi çoi në ngacmime dhe komente diskriminuese, duke synuar jo vetëm çiftin por edhe fëmijët si grup demografik. Komentet varionin nga mbështetje për “vendimin” e tyre deri në armiqësi të hapur, ku zgjedhja e çiftit u përdor si justifikim për sulme mbi bazë moshe ose paragjykime kulturore. Shembuj të tjerë: http://www.instagram.com/p/C_aHD_OAS1s/?igsh=MTR0aG5lN3hnMnBia Përshkrime si “Voto në story për ‘Turpi i Muajit’! Kush e meriton kurorën?” nxisin tallje publike dhe HDD. Termi “haram”, me origjinë nga arabishtja, përdoret shpesh në diskursin publik për të etiketuar diçka si të ndaluar, imorale ose të turpshme; përdorimi i tij në formate interaktive	Në vazhdim	Agjentët e ndryshimit të AMAD-it kanë monitoruar këtë media dhe po përgatisin një dokument analitik për t’u paraqitur pranë institucioneve kombëtare që adresojnë këtë çështje.

		ngacmim online dhe gjuhë urrejtjeje (sulme të drejtuara ndaj subjektit në TikTok)		(sondazhe, story) ka efekte të dukshme negative në mjedisin digjital.		
7	UEFA 2024 – Media	Diskurs urrejtës etnik	Lojtarë futbollit dhe tifozë (Shqipëri, Kroaci, Serbi)	Qershor 2024 – UEFA EURO 2024. Futbollisti i kombëtares shqiptare Mirind Daku u filmua duke brohoritur parulla nacionaliste dhe provokuese ndaj tifozëve maqedonas, përfshirë “Shqipëri etnike”, “Maqedonia është tokë shqiptare” dhe “Maqedonia është Shqipëri”, slogane të lidhura me nacionalizmin shqiptar në disa pjesë të Maqedonisë së Veriut. Videoja u përhap gjerësisht, duke nxitur kritika për natyrën politike dhe nxitëse. Incidenti u shfaq në kontekstin e një serie provokimesh dhe tensionesh gjatë turneut. Janë dokumentuar edhe raste të tjera: tifozë shqiptarë me simbole provokuese (p.sh. harta e “Shqipërisë së Madhe”, emblema të UÇK-së) që çuan në gjoba për Federatën Shqiptare të Futbollit; si dhe akuza ndaj tifozëve kroatë dhe serbë për thirrje nxitëse gjatë ndeshjeve përkatëse.	I regjistruar	Rasti i Dakut mbetet shembull me profil të lartë i ndikimit të incidenteve politike dhe etnike në sportin e Ballkanit. Edhe pse lojtari kërkoi ndjesë për veprimet e tij, reagimi publik dhe pasojat tregojnë nevojën për theksim të sportivitetit dhe parandalim të përshkallëzimit të tensioneve në arenat sportive. Lidhje: https://www.reuters.com/sports/soccer/albanian-player-apologises-encouraging-offensive-fan-chants-2024-06-21/
8	NOA – platformë online mediatike	Stereotipizim gjinor / Shkelje e edukimit mediatik	Gazetar digjital / Media NOA	Tetor 2024 – Një artikull i publikuar nga NOA mbi një aksident automobilistik raportoi ngjarjen duke theksuar në mënyrë të panevojshme gjininë e drejtueses së mjetit, duke sugjeruar se veprimet e saj ishin të rëndësishme për shkak të gjinisë. Ky kornizim mund të përforcojë paragjykime gjinore dhe të ndikojë negativisht në perceptimin e lexuesve. Lidhje: https://noa.al/ajini/2024/22.html	I adresuar	AMAD ka planifikuar trajnime për gazetarë dhe studentë të gazetarisë, me fokus në etikën mediatike dhe raportimin pa paragjykime gjinore.
9	Media të gjera dhe rrjete sociale	Gjuhë seksiste	Publiku	Shtator 2024 – Emanuela Rusta, gjyqtarja e parë femër në futbollin shqiptar, bëri publike se ishte sëmurë nga kanceri. Një segment i diskursit publik e reduktoi këtë fakt në narrativën seksiste “ajo është seksi”, duke minimizuar profesionalizmin e saj. Mesazhet mizogjiniste u përhapën në llogarinë e saj në Instagram. Rusta theksoi se ishte përballur me komente të bazuara në pamje fizike dhe jo në	I adresuar	Rasti u adresua nga AMAD si një nevojë për të përfshirë HDD-në dhe gjuhën seksiste si prioritet në ngritjen e ndërgjegjësimit gjatë vitit të dytë (2025) të zbatimit të projektit LIFE.

				profesionalizëm, dhe u detyrua të fshinte llogarinë për shkak të përmbajtjeve fyese. Lidhje: https://www.the-sun.co.uk/sport/13560715/womens-champions-league-referee-emanulela-rusta-instagram/		
10	Top Channel – media kombëtare / Big Brother VIP	Mizogjini dhe objektivizim i grave; gjuhë seksiste dhe fytes	Inlisa Agolli (banore), Lediona Erjona Doci (moderatore)	Mars 2024 – Big Brother VIP Albania. Inlisa Agolli përdori në mënyrë të përsëritur gjuhë degraduese ndaj banoreve femra, duke i quajtur “të mjelura” nga burrat dhe duke sugjeruar se janë të pavlera pa një figurë mashkullore. Moderatorja Lediona Erjona Doci u përpoq ta sfidonte këtë diskurs, por Agolli reagoi në mënyrë provokuese, duke pohuar se gratë “vullnetarisht” përfshihen në këto dinamika dhe duke vazhduar me komente fyese ndaj grave. Rasti u bë viral dhe nxiti debat publik mbi mizogjininë, lirinë e shprehjes dhe normalizimin e gjuhës fyese në programet reality.	I adresuar	AMAD e referoi rastin pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Institucionet kontaktuan median dhe Top Channel për të adresuar çështjen dhe për të kërkuar ndërhyrje ndaj pjesëmarrësve në këtë program televiziv.
11	Top Channel dhe platforma sociale	Gjuhë seksiste; manipulim mediatik për klikbait / Shkelje e edukimit mediatik	Top Channel; Kostana Morava (figurë publike)	Tetor 2024 – Kostana Morava, figurë e njohur në Shqipëri, akuzoi Top Channel për shtrembërim të intervistës së saj mbi përvojat me ngacmimin seksual në vendin e punës. Ajo pretendoi se titulli dhe mënyra e raportimit manipuluan fjalët e saj, duke keqinterpretuar qëndrimin dhe duke nxitur ngacmim seksual dhe diskurs publik nxitës. Media u kritikua për sensacionalizëm dhe për reduktimin e ndikimit të mesazhit të saj, si dhe për dëmtimin e besueshmërisë dhe stigmatizimin e çështjes së ngacmimit seksual. Debatu publik gjatë vitit 2024 çoi në kritika të gjera ndaj Top Channel dhe nxiti diskutime mbi etikën dhe përgjegjësinë mediatike në trajtimin e temave të ndjeshme.	I adresuar	Opinionu publik u nda, me shumë mbështetje për qëndrimin e Moravës dhe disa kritika ndaj praktikave mediatike. Rasti thekson nevojën që
12	Media online	Shantazh online, ngacmim	Individë; Altin Çoku (rast shembullor)	Shkurt 2024 – Altin Çoku, 39 vjeç nga Kamza, u arrestua për mbajtje të paligjshme të armëve dhe u dyshua për ndërtimin e një bodrumi në banesën e tij për të fshehur persona të tjerë. Gjithashtu, u raportua se Çoku i dërgonte një grua foto intime të saj, të marra nga TikTok, duke pretenduar se një mik i kishte siguruar pas një takimi të vetëm. Policia po heton raste të tjera të mundshme, përfshirë një në Laç, ku Çoku dyshohet për shantazh të një gruaje tjetër me foto të ngjashme. Rasti i Sibela Abedinit nxiti debat të gjerë publik mbi vetë-	I adresuar	Rasti u adresua nga AMAD si prioritet për përfshirje në ndërgjegjësim publik dhe edukim digjital gjatë vitit të dytë (2025) të zbatimit të projektit LIFE.

				ekspozimin online dhe viktimë-fajësimin. Shumë përdorues përdorën terma fyese si “kurvë” dhe e akuzuan viktimën se “e kërkoi vetë”, duke përforcuar narrativa të dëmshme. Kjo tregon problematika të thella shoqërore mbi privatësinë, përgjegjësinë dhe prirjen për t’ua ngarkuar fajin grave për veprime të kryera nga të tjerë.		
13	ABC News	Ngacim verbal me bazë gjinore, mizogjini dhe turpërim publik	Burim parësor: Arben Mediu (komentator politik) Burim dytësor: Avokati Bozheku (përgjigje mbrojtëse gjatë përshkallëzimit)	Qershor 2024 – Një debat i nxehtë politik në një studio televizive u përshkallëzua në sulme verbale. Analisti Arbën Mediu përdori fyerje me bazë gjinore (“prostitutë”) ndaj avokates Bozheku, duke e përkeqësuar debatin. Bozheku reagoi në mënyrë mbrojtëse, çka e përshkallëzoi më tej situatën. Sjellja e Mediut u karakterizua nga ofendime mizogjiniste dhe diskurs joprofesional, duke çuar në largimin e tij nga studioja. Lidhje: https://newsbomb.al/aktualitet/video-thashe-erdhi-tende-degienro-deshte-studio-nje-analist-i444395 https://kohlibr.al/video-prostitute-thuaji-gruas-tende-plas-sherri-ne-studio-mes-analistit-me-avokates/	I adresuar	Rasti u adresua nga AMAD si nevojë për komunikim etik nga figurat publike dhe u vendos si prioritet për ndërgjegjësim gjatë vitit të dytë (2025) të zbatimit të projektit LIFE.
14	Media kryesore dhe platforma online	Agresion verbal, fyerje personale (përfshirë komente me bazë gjinore dhe mbi pamjen fizike)	Albana Vokshi (deputete e PD dhe Kryetare e Komisionit për Çështjet Sociale); Ilir Meta (deputet i PS)	Tetor 2024 – Incidenti ndodhi gjatë një seance parlamentare që u përshkallëzua në përballje verbale dhe fizike. Deputetja Albana Vokshi e përshkallëzoi situatën duke i hequr fizikisht mikrofonin deputetes Planida Ndreca, duke nxitur tensione të larta. Deputeti Ilir Meta e përkeqësoi më tej situatën duke vënë në dyshim gjendjen mendore të Vokshit dhe duke sulmuar pamjen e saj fizike, duke i dhënë debatit një nëntekst gjinor dhe diskriminues. Rasti pasqyron sfidat e thella në nxitjen e dialogut politik konstruktiv dhe adresimin e diskursit të dëmshëm gjinor. Media e Top Channel e trajtoi incidentin në mënyrë sensacionaliste, duke u fokusuar te fyerjet personale dhe jo te raportimi faktik. Mediat dhe institucionet dështuan sërish në rolin e tyre për promovimin e profesionalizmit, barazisë gjinore dhe llogaridhënies në forumet publike. Lidhje: www.youtube.com/watch?v=lkcv7z_xMA	I adresuar	Rasti u adresua nga AMAD si nevojë për komunikim etik të figurave publike dhe u vendos si prioritet për përfshirje në ndërgjegjësim publik gjatë vitit të dytë (2025) të zbatimit të projektit LIFE.

15	TV Klan – talk show “Opinion”	Stereotipizim racor dhe diskriminim; përdorim i gjuhës fyese ndaj komuniteteve minoritare (romë dhe egjiptiane); normalizim i retorikës ofenduese dhe përjashtuese	Alma Çupi – gazetare dhe e ftuar në emisionin “Opinion”	Gjatë një diskutimi mbi plazhet publike dhe private në Shqipëri, gazetarja Alma Çupi përdori termin fyes “jevgjit” për të përshkruar zaptimin e plazheve. Ky term, një fyerje e përdorur shpesh në Shqipëri, synon komunitetet rome dhe egjiptiane dhe përforcon stereotipe të dëmshme. Reagimi publik ishte i gjerë dhe i menjëhershëm, veçanërisht nga komunitetet minoritare dhe aleatët e tyre. Rasti nxjerr në pah nevojën urgjente për adresimin e paragjykimeve sistematike në diskursin publik dhe mediatik. Media kontribuoi në sensacionalizimin e termit. Lidhje: www.youtube.com/watch?v=MIAM11JvF04 www.panorama.com.al/si-jevgjit-gazetarja-alma-cupi-ofendon-komunitetin-rom-e-egjiptian-rike-raci-reagon-ashper-injorante-boll/	I adresuar	AMAD e referoi rastin pranë institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (NHRI). Alma Çupi paraqiti ndjesë publike, duke u distancuar nga deklaratat fyese dhe duke sqaruar se qëllimi i saj nuk ishte diskriminimi apo ofendimi. Lidhje: www.classlifestyle.com/news/67290/si-jevgjit-alma-cupi-kerkoi-ndjese-publike-pasi-deklarates-fyese/
----	-------------------------------	--	---	---	------------	--